



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kryetari i Komunës propozon:

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 07/I-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës , Ligji nr. 03/I-049 për Financat e Pushetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2021 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM PËR LIRIMIN NGA PAGESA E QIRASË JOPROFITABILE TË PËRFITUESVE TË BANIMIT SOCIAL

Neni 1

LIROHEN , nga pagesa e qirasë joprofitabile për vitin 2021 të gjithë përfituesit e banimit social duke përfshirë periodën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021.

Neni 2

Lirimi nga pagesa e qirasë joprofitabile për kategoritë e lartëcekura bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike në këtë kohë të përballjes me pandeminë COVID -19.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor juridik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16, 17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008.

Duke u bazuar në rritjen e numrit të rasteve me pandeminë botërore COVID -19, Komuna e Lipjanit sikurse edhe komunat tjera të Republikës së Kosovës edhe në këtë vit është në situatë emergjente dhe e konsideron të domosdoshme krijimin e disa lehtësirave financiare për përfituesit e banimit social të cilët përveq gjendjes së rënduar sociale po përballen edhe me pandeminë dhe e kanë të vështirë në këtë situatë ti kryejnë me rregull pagesat e qirasë joprofitabile. Familjet e cekura edhe vitin e kaluar me Vendim të Kuvendit të Komunës janë liruar nga pagesa e qirasë joprofitabile .

Komuna e Lipjanit me këtë propozim –vendim kërkon nga Kuvendi i Komunës që përfituesit e banimit social të lirohen nga pagesa e qirasë për vitin 2021 ku përfshihet perioda prej datës 01.01.2021 deri më 31.12.2021.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 1-011-19542

Lipjan, më 14.04.2021

KRYETARI KOMUNËS

Imri Ahmeti

